



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 256, Datë 15.10.2025

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 241, DATË 02.12.2021,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING” SH.P.K.
NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, me nr. 2548/2 prot., datë 11.10.2025 “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 157, datë 31.07.2024 “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 241, datë 02.12.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, të ndryshuar”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “ALBESP TRADING & CONSULTING” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 241, datë 02.12.2021, të ndryshuar me vendimin nr. 82, datë 24.04.2025, ka licencuar shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, deri më datë 02.12.2026.
- Në dispozitivin e këtij vendimi, ERE ka vendosur që shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën e qirasë së zyrave që disponon, jo më vonë se 1 (një) muaj pas rinovimit të saj (afati i përfundimit: 01.11.2025). Ky vendim do të jetë objekt rishikimi nga ERE, në varësi të përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në këtë pikë.

2. Kërkesa e shoqërisë dhe dokumentacioni i depozituar

- Me shkresën nr. 2548/1 prot., datë 07.10.2025, shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. ka depozituar kontratën e qirasë me nr. 7049 Rep., nr. 3095 Kol., datë 04.08.2025, për përdorimin e një sipërfaqeje prej 76 m² në adresën Rr. “Vaso Pasha”, Hyrja 1, Apartamenti 10, Tiranë.
- Kjo kontratë është nënshkruar për një afat 1 (një)-vjeçar, me të drejtë përsëritjeje, dhe hyn në fuqi pas përfundimit të kontratës paraprake me nr. 11086 Rep., nr. 3452 Kol., datë 22.11.2022, e cila ka afat deri më 01.11.2025.

- Nga shqyrtimi rezulton se kontrata e re e qirasë ka vlefshmëri deri më 01.11.2026, pra nuk mbulon plotësisht afatin e vlefshmërisë së licencës së shoqërisë (02.12.2026).

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Në përputhje me pikën 2.4, gërmën “c” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë informacion mbi disponimin e zyrave përfaqësuese me adresat përkatëse.
- Depozitimi i kontratës së qirasë me nr. 7049 Rep., nr. 3095 Kol., përbën plotësim të pjesshëm të kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit nr. 82/2025, pasi afati i saj nuk mbulon plotësisht periudhën e vlefshmërisë së licencës.
- Për këtë arsye, vlerësohet e nevojshme që pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 241/2021, i ndryshuar me vendimin nr. 82/2025, të ndryshohet për të përcaktuar një afat të ri konkret për depozitimin e kontratës së rinovuar.

4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Duke qenë se afati i vlefshmërisë së kontratës së qirasë të depozituar (01.11.2026) nuk përputhet plotësisht me afatin e licencës (02.12.2026), dhe në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, vlerësohet që pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 241/2021, i ndryshuar, të ndryshohet si vijon: *“Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën e qirasë së zyrave të rinovuar, brenda datës 01.11.2026.”*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 241, datë 02.12.2021, e ndryshuar me vendimin nr. 82, datë 24.04.2025, ndryshon dhe bëhet: *“Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën e qirasë së zyrave të rinovuar, brenda datës 01.11.2026.”*
2. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarëve, të njoftojë shoqërinë *“AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k.*, lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI